

**RAPORTI**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit BSc në Shkenca Politike e Administrative me profile:**


- i. **Shkenca Politike**
- ii. **Administratë Publike.**

**Ofruar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Merita Vaso Xhumari

Klodiana Beshku (Ph.D)



(Shtator/2018)

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc. Shkenca Politike e Administrative me profil:

- i. Shkenca Politike;
- ii. Administratë Publike

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	*UMAS Nr. 482, dt. 03.10.2011.
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	**UMASH Nr 124, dt 29.03.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bsc në Shkenca Politike e Administrative me profil: Shkenca Politike; Administratë publike.
6	Cikli i studimit:	Bachelor
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	180
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
17	Numri i studentëve	196
	Etj	

\*Sipas UMAS Nr 482, dt 03.10.2011 emërtimi i këtij programi është Bachelor në "Shkenca politike dhe Administrative"

- i. "Shkenca politike"
- ii. "Administratë publike"

\*\* Sipas Urdhërit të akreditimit të parë, UMASH Nr 124, dt 29.03.2012 emërtimi i programit është: Bachelor në "Shkenca politike-Administratë Publike me profile:

- i. "Administratë publike"
- ii. "Shkenca politike"

**Ka mospërputhje me emërtimin e programit të studimit midis Urdhërit të licensimit dhe Urdhërit të akreditimit të parë.**

### **Shënim:**

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

## HYRJE

**Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profil në: Shkenca Politike; Administratë Publike:**

Programi Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me profil Shkenca Politike dhe Administratë Publike është pjesë e programeve të studimit të Universitetit “Mesdhetar i Tiranës” (UMSH).

Emërtimi i këtij programi studimi ka pësuar ndryshime që nga koha e licensimit të tij, si më poshtë:

- Vlerësimi i parë në kuadër të hapjes është VKA Nr. 198, datë 24.06.2011 “Për riorganizimin e Programeve të Studimit Diplomë e Nivelit të Parë në Bachelor të Shkollës së Lartë Private “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”. Sipas VKA, Këshilli i Akreditimit, pasi shqyrtoi propozimin për riorganizimin e Programit në **Bachelor në: “Shkenca Politike dhe Administrative” me 2 profile: Shkenca Politike, Administratë Publike**, vendos kushtet e mëposhtme, pas plotësimit dhe verifikimit të të cilave jep vlerësimin përfundimtar. Kushtet:
  - Të qartësohet mënyra se si ndodh dhe cilat janë modulet/lëndët për organizimin dhe ndarjen në profile të programit të studimit.
  - Të paraqitet një bërthamë tekstesh bazë (në gjuhën shqipe) dhe ndihmëse.
  - Programi të orientohet nga konteksti dhe tradita e zhvillimit të shkencave politike në Shqipëri. Për këtë sugjerohet që profilizimi për administratën publike të bëhet më i qartë ose të konceptohet si një studim I mëtejshëm në një program master i shkencave ose professional. Përndryshe mbi rekomandimet e Procesit të Bolonjës programet me dy profile duhet të jenë dy-disiplinore e jo brenda një disipline.
- Me UMASH Nr. 482, datë 03.10.2011 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë ‘Bachelor’, programeve të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Shkollën e Lartë Private ‘Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë’, emërtimi i këtij programi studimi mbështetur në Vendimin Nr 233, datë 16.09.2012 të Këshillit të Akreditimit, i cili ka shqyrtuar propozimin për plotësimin e kushteve të vendosura në VKA Nr 198, datë 24.06.2011 është: **Bachelor në “Shkenca politike dhe administrative” me profile: i. “Shkenca politike” ii “Administratë publike”**
- Me UMASH Nr 124, datë 29.03.2012 “Për akreditimin Institucional dhe programeve të studimit “Bachelor” në “Ekonomi”, “Marrëdhënie Ndërkombëtare/Diplomaci”, “Shkenca Politike-Administratë Publike” të Institucionit ‘Shkolla e Lartë Private Mesdhetare eShqipërisë’”, emërtimi i programit të studimit, mbështetur në VKA Nr 303, datë 13.01.2012 të Këshillit të Akreditimit, është **Bachelor në “Shkenca politike-Administratë publike” me profile: i. “Administratë publike”, ii. “Shkenca politike”**. Programi i studimit akreditohet sipas rekomandimeve të vendosura në VKA Nr 303, datë 13.01.12. Për plotësimin e këtyre rekomandimeve, GVJ është shprehur më poshtë.
- Sipas Shkresës të Sekretarit të Përgjithshëm të MASH, Nr 5503/1 prot, datë 03.10.2012 “Dërgohen numrat e identifikimit”, sipas rregjistrimit në Rregjistrin Shtetëror të Diplomave e Certifikatave të Arsimit të Lartë e Kërkimit Shkencor, të formave të diplomave me formë studimi me kohë të plotë, emërtimi I programit të studimit është **Bachelor në “Shkenca politike e administrative” me profile: i. Shkenca politike, ii. “Administratë publike”**
- Sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr 6/1, datë 19.05.2017, emërtimi i këtij programi paraqitet **Bachelor në Shkenca Politike me profile: Shkenca Politike; Administratë publike**.
- Fakulteti përgjegjës për këtë program është Fakulteti I Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Ky Fakultet është hapur me UMAS Nr 273, datë 18.05.2017 “Për hapjen e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike” dhe Riorganizimin e Njësisë kryesore nga “Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike” në “Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare” të Shkollës së Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë”. Sipas këtij UMAS, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ka në përbërje të tij këto Departamente:

- a) Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë
- b) Departamenti i Shkencave Politike
- c) Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë

Sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr 6/1, datë 19.05.2017 Departamentet përgjegjëse për këtë program janë: Departamenti i Shkencave Politike i cili organizon programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike me profil: Shkenca Politike dhe Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë i cili organizon programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike me profil: Administratë Publike.

Pra, ndërsa në Urdhërin e MASH Nr. 124, datë 29.03.2012 programi emërtohet “Bachelor” në “Shkenca politike-Administratë publike” me profile: i. “Shkenca Politike”, ii. “Administratë Publike”, ky emërtim nuk përdoret në RVB-në e paraqitur nga IAL-ja në Mars 2018.

Sipas RVB, emërtimi i programit paraqitet **“Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me profil: Shkenca Politike dhe Administratë publike”**.

**Emërtimi që do të merret për bazë tani e tutje nga GVJ është “Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profil: Shkenca Politike dhe Administratë publike”**. Aktualisht, ky program është në proces riakreditimi.

Ky riakreditim bazohet në Raportin e vlerësimit të brendshëm të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”; në dokumentacionin shtesë të përcjellë nga ky institucion, në përputhje me dispozitat e MAS dhe ASCAL dhe në kërkesat e Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Aktualisht, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ka gjithsej:

25 Personel akademik me kohë të plotë (PAE), nga të cilët 15 janë me tituj/grada

9 personel akademik më kohë të pjesshme (PAK), nga të cilët 6 me tituj/grada.

Në Departamentin e Shkencave Politike, aktualisht ka:

8 PAE- nga të cilët 6 me gradë shkencore/tituj,

3 PAK - nga të cilët 2 me gradë shkencore/tituj

Në Departamentin e Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, aktualisht ka:

7 PAE - nga të cilët 3 me gradë shkencore

dhe 0 PAK.

Në Programin Bsc. Shkenca Politike dhe Administrative, profili Shkenca Politike japin mësim 17 PAE dhe 6 PAK, ndërsa në profilin Administrim Publik japin mësim 20 PAE dhe 6 PAK.

Numri i studentëve që ndjekin programin Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative është 196 studentë, referuar RVB faqe 10, Tabela nr. 2. Më konkretisht në vitin akademik 2017-2018 ka 50 studentë në vitin e parë, 42 në vitin e dytë dhe 104 studentë janë në vitin e tretë.

Nga të dhënat e ofruara nga IAL-ja, rezulton se të paktën 120 studentë në Fakultetin e Psikologjisë, Shkencave Politike dhe Administrimit, janë me bursë të pjesshme/plotë.

## GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

~~Perberja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Asoc. Dr. Merita Xhumari dhe Dr. Klodiana Beshku eksperte të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.~~

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatorin Teknik i ASCAL: Znj. Suela Kromidha.

Me datë 19.09.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 24.09.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe vendosën të sa më poshtë:

GVJ shqyrtoi me vemendje komentet e institucionit mbi RVJ dhe vlerëson konfirmimin e konstatimeve të bëra në lidhje me përmbushjen e standardeve të cilësisë. Sa i takon disa

objeksioneve ato përcjellin angazhimin e institucionit në përmbushjen e standardeve të plotësuara pjesërisht, për të cilat edhe GVJ ka shprehur besimin se UMSH ka strategji dhe kapacitete për përmbushjes e tyre. Më specifikisht do të veçonim:

1. GVJ ka përcaktuar si mungesë fleksibiliteti faktin që nuk ka pasur të parashikuara lëndë me zgjedhje në profilin Administrate Publike, dhe fakti që UMSH e ka permiresuar këtë program për vitin 2018-2019 standardizbatohet për periudhen në vijim.
2. Sa i takon masës së krediteve të programit të studimit në vitin e parë 56 ECTS dhe vitin e dyte 64 ECTS, argumenti që janë bërë ndryshime për vitin akademik në vijim 2018-2019 konfirmon se standardet do të plotësohen në vijim me 60 ECTS për çdo vit akademik.

Si përfundim, GVJ konsideron të vlefshme të gjitha konstatimet e theksuara si objeksione, por që në fakt trajtohen më tepër si objektiva që UMSH merr përsipër t'i reflektojë në vitin akademik në vijim.



## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

Në Vendimin e Këshillit të Akreditimit nr.303, datë 13.01.2012 për programin e studimit "Bachelor Shkenca Politike – Administratë publike, me profile: Administratë publike; Shkenca Politike" jepen këto rekomandime:

- a) Përmirësimi dhe azhurnimi i programit të studimit dhe profileve të tij të kryhen në vazhdimësi, duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur të vendit dhe botërorë.
- b) Të shikohet mundësia e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë, të rekrutohen personel akademik me tituj/grada shkencore përkatëse dhe të bashkëpunohet me pedagogët aktualë (të cilët në një periudhë 1-3 vjeçare të jenë pajisur me tituj/grada shkencore).
- c) Të përfshihen në planin mësimor për këtë program studimi, të paktën dy lëndë me zgjedhje për çdo profil.
- d) Të parashikohen mënyra për të tërhequr student të rinj dhe me rezultate të larta.

### Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin (a) institucioni nuk ka bërë ndryshime në planin mësimor për periudhën 2012-2018, as në përmbajtjen e lëndëve as në formë. Ndonëse personeli akademik ka ndryshuar, është rritur në numër personeli akademik efektiv dhe me grada shkencore, plani i lëndëve mësimore ka mbetur i pandryshuar, si dhe nuk ka ndryshuar në futjen e lëndëve me zgjedhje. Biblioteka e Universitetit me tituj të rinj e autorë bashkëkohorë, mund të ishte vendosur më mirë në funksion të përmirësimit të profileve të lëndëve të programit në fjalë.
  - b) Sa i takon elementeve të formës, referuar sasisë së krediteve 56 ECTS viti i parë dhe 64 ECTS viti i dytë, ato nuk reflektojnë standardin e sigurimit të 60 ECTS në çdo vit akademik.
  - c) Për rekomandimin (b), institucioni ka rritur numrin e pedagogëve me kohë të plotë kryesisht nëpërmjet marrjes së gradës nga pedagogët efektivë të mëparshëm, por edhe disa rekrutimeve nga jashtë. Në Departamentin e Shkencave Politike, aktualisht ka: PAE: 8 (nga të cilët 6 me gradë shkencore/tituj), PAK: 3 (nga të cilët 2 me gradë shkencore/tituj), ndërsa në Departamentin e Administrimit Publik dhe Formimit Bazë. PAE: 7 (nga të cilët 3 me gradë shkencore), PAK: 0. Megjithatë, departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë duhet të fuqizohet akoma më tepër, edhe nëpërmjet rekrutimit të PAK-ve, ndoshta nga administrata publike, me qëllimin që të sjellin në auditor eksperiencën e tyre në terren.
  - d) Rekomandimi (c) është plotësuar pjesërisht, sepse mungojnë lëndët me zgjedhje në profilin Administrim Publik dhe vetëm në planin mësimor të profilit Shkenca Politike tashmë ka të paktën dy lëndë me zgjedhje: Filozofi politike dhe Politika e jashtme e ShBA-së.
  - e) Për rekomandimin (d), institucioni e ka shtuar vëmendjen ndaj studentëve dhe rekrutimeve të reja. Pavarësisht se programi është ndihmuar së tepërmi nga reforma në administratën publike e nisur në vitin 2014, ka ndihmuar shumë në rritjen e kërkesës për këtë degë. Gjithsesi, IAL-ja, me qëllim tërheqjen e studentëve me mesatare të lartë, ka aplikuar dhënien e bursave për studentët e rinj të kësaj kategorie.
- Si konkluzion i këtyre fakteve, mund të thuhet se institucioni ka punuar për përmbushjen e rekomandimeve, por ka ende punë për përmirësimin e atyre rekomandimeve që lidhen me përmirësimin e programit të studimit dhe planit mësimor.

# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me profil: Shkenca Politike dhe Administratë Publike, i akredituar për herë të parë në vitin 2012 referuar Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 124, date 29.03.2012 dhe VKA Nr. 303 date 13.01.2012, aktualisht në proces riakreditimi, është një program i cili i përgjigjet kërkesave në rritje për këtë degë nga ana e studentëve të rinj. Si rrjedhojë, misioni/objektivat e këtij programi studimi kryesisht kanë të bëjnë me përgatitjen praktike dhe teorike të studentit, të përshtatura me kohën dhe nevojat aktuale të tyre dhe të zhvillimit të vendit. UMSH ka hartuar një Strategji të Zhvillimit të Programit të Studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative. Objektivi kryesor i programit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me 2 profile është t'i pajisë studentët me njohuritë themelore për formimin e tyre si specialistë të shkencave politike dhe administratës publike. Për realizimin e këtij objektivi programi mësimor parashikon mësimdhënien e njohurive bazë në sociologji, shkenca politike, lidërsip, sistemet politike, teoritë e demokracisë, filozofi politike, administratë publike, politikat publike, politikat buxhetore, etj., të domosdoshme për vazhdimin e studimeve të thelluara në fushën e shkencave politike dhe administratës publike në programet e ciklit të dytë Master Shkencor e Master Profesional që ofrohen nga UMSH. Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program studimi dhe aftësitë e kompetencat që do të zotërojnë studentët pas përfundimit të nivelit Bachelor, do t'ju krijojnë atyre mundësinë edhe për ndjekjen e një karriere kërkimore nëpërmjet vazhimit të studimeve të Masterit Shkencor, jo vetëm në fusha shkencore të përafërta me shkencën politike dhe administratën publike, por edhe në Shkencat Ekonomike, Juridike, të Biznesit, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Gazetari, etj. Pas përfundimit të këtij programi studimi, në sajë të njohurive të marra, studenti aftësohet për punësim në sektorin publik dhe në atë privat, në administratën shtetërore në nivel lokal dhe qendror, apo organizata të ndryshme të shoqërisë civile.

Këto qëllime dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata janë në funksion të IAL-së, studentëve të tij janë në përputhje me prioritetet kombëtare, kjo sipas Rregullores së Fakultetit, Rregullores së programit dhe RVB-së, të paraqitura në sistem.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Programi është dëshmi e rritjes institucionale të UMSH.
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	Objektivat, formimi, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale të studentit janë të qarta si në program, ashtu edhe në Rregulloren dhe Statutin e tij. Ato janë në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, nivelin 6.
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje	

<p>me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Në përputhje me zgjerimin e Statusit të nëpunësit civil dhe nevojave në rritje të Administratës Publike, ky program duket se i ka rrokur më së miri këto dinamika, pra nevojat e tregut të punës së bashku me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Programet e studimit janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit që kërkon nëpunës profesionistë në administratën publike dhe specialistë të shkencave sociale.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programet e studimit janë përshtatur me Strategjinë e UMSH, rekomandimet e akreditimit të parë dhe motos së institucionit ‘studenti në qendër’.</p> <p>Është synuar zgjerimi por edhe ruajtja e cilësisë, formimi bazik i studentit, por edhe ai specifik sipas profileve duke ndryshuar në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve.</p> <p>Vihet re një konceptim i programeve i cili dallon për secilin prej profileve. Profili në Shkenca Politike është i drejtuar në një nivel mbi kombëtar, ndërsa ai në administratë publike është më teknik e bazik, kjo në lidhje edhe me rekomandimet e Këshillit të Akreditimit të mëparshëm.</p>
<p><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b></p>	
<p><b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative është krijuar pas një hulumtimi të kujdesshëm mbi hapësirat e lëna prej përthithjes së studentëve nga tregu i punës.</p> <p>Ndonëse nuk ka një studim të mirëfilltë në këtë drejtim, grupi i punës është bazuar mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Statistikat e studentëve të regjistruar në rritje;</li> <li>Punësimin e të diplomuarve;</li> <li>Institucionet me të cilat bashkëpunohet.</li> </ol> <p>Në këtë kuadër, programi në fjalë është parë si i domosdoshëm, sidomos pas forcimit të ligjit mbi Statusin e Nëpunësit Civil. Kjo është evidentuar me një <i>boom</i> regjistrimesh në këtë program, për vitin akademik 2017-2018.</p>
<p><b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Duket se për hartimin e këtij program, grupi i punës i Universitetit Mesdhetar Shqiptar është bazuar, në mënyrë hierarkike, mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020</li> <li>Reformën mbi Administratën Publike (2015-2019)</li> <li>Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH nr.80/2015.</li> <li>Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit përkatës</li> <li>Statutine brendshëm dhe Rregulloren e UMSH-së</li> </ol> <p>Si rrjedhojë, programi nuk përmban elementë të cilët të bien ndesh me interesat kombëtarë.</p> <p>Programet synojnë të ruajnë vlerat kombëtare referuar literaturave të studjuesve shqiptarë në syllabuset e lëndëve dhe metodave për realizimin e tyre.</p>



### Konkluzionet e vlerësimit:

1. Ndonëse mungon një studim i mirëfilltë i tregut, duket se kjo nuk e ka zbehur seriozitetin e punës për zhvillimin e një programi Bachelor në Shkenca Politike e Administrative. Puna për këtë program, duket se është ndihmuar prej ndryshimit të statusit të IAL-së nga Shkollë e lartë në Universitet, Reformës në administratën publike dhe sigurisë që vjen tashmë prej Statusit të Nëpunësit civil që ka vendosur kriterin e diplomës Bachelor.
2. Në kuadrin makro të plotësimit të standarteve, programi përputhet plotësisht, si me nevojat kombëtare e vlerat kulturore kombëtare, ashtu edhe me nevojat dhe parimet e IAL-së e të Fakultetit përkatës, të cilët duket se janë në ekspansion të vazhdueshëm.

Në linjat e përgjithshme, sa më sipër, standartet përmbushen.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi Bachelor në Shkenca politike e Administrative me profile organizohet nga Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike (FSHPSP) të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Referuar klasifikimit ndërkombëtar të fushave të studimit ku Psikologjia, Sociologjia dhe Shkencat Politike janë të treja të përfshira në klasifikimin Shkenca Sociale, ky term do të ishte adekuat. Fakulteti synon të përgatisë psikologë, sociologë, politologë dhe specialistë të administratës publike. Gjithashtu, ai synon rritjen e cilësisë të kërkimit shkencor në fushat përkatëse. Ky fakultet ofron 3 programe studimi në nivelin e parë Bachelor; 3 programe studimi në nivelin Master Shkencor; 2 programe studimi Master Professional. Ai ka në përbërje Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) si edhe personel administrativ, i cili është i mjaftueshëm. Baza e të dhënave të njësisë gjendet në Zyrën e Burimeve Njerëzore, Sekretarine mësimore, njësinë bazë dhe atë kryesore. Përgjegjësia e mbajtjes dhe e dhënies së informacionit i përket drejtuesve të hallkave sa më sipër. Informacioni bazë është lehtësisht i deduktueshëm edhe në web-in e Universitetit: [www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al)

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është i strukturuar me tre Fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike dhe Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Me Vendim Senati nr.6/1, datë 19.05.2017 organizimi i programit ka kaluar nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në Fakultetin e Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ku profili a. Shkenca Politike ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike; kurse profili b. Administratë Publike ofrohet nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë. Pas riorganizimit të brendshëm në vitin 2017, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ka në përbërje tre departamente të cilët funksionojnë si njësi bazë:

1. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë
2. Departamenti i Shkencave Politike
3. Departamenti i Administrimit publik dhe Formimit bazë

Mbështetur në RVB, faqe 16, përgjegjës për programin e studimit Bsc në Shkenca Politike e Administrative përgjegjës për këtë program është Departamenti i Shkencave Politike. Nuk përmendet Departamenti i

Administrimit Publik dhe Formimit bazë si përgjegjës edhe ai për këtë program studimi siç paraqitet në Vendimin e Senatit Nr 6/1, dt 19.05.2017

Në RVB (Aneksi 10) gjendet edhe një organigramë e strukturës akademike e fizike e Fakultetit.

Stafi i brendshëm i fakultetit është i organizuar në disa bërthama (grup-lënde) ku ndodhen pedagogë të fushave të studimit të përafërta.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Në RVB e paraqitur (fq. 17), gjenden të dhënat e detajuara në lidhje me stafin akademik të Fakultetit si edhe të të dy Departamenteve përgjegjës. Numrin e personelit akademik të Departamenteve përbërëse të fakultetit përgjigjes e gjeni në *Anekse, Tabela 1*.

Departamenti i Shkencave Politike ka në përbërje të tij 8 personel akademik efektiv (jo 9 PAE siç është paraqitur në RVB faqe 17), nga të cilët 5 janë Dr dhe 3 janë Msc.

Në këtë Departament japin mësim 3 PAK, nga të cilët 1 Dr; 1 Dr në proces dhe 1 Msc

Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit bazë ka në përbërje të tij 7 PAE, nga të cilët 3 janë me tituj dhe grada dhe 0 PAK. Nuk ka të dhëna të detajuara për këtë Departament dhe për titujt dhe gradat e stafit të tij.

Nga viti 2012 i akreditimit të parë, Departamenti i Shkencave Politike ka përmirësuar cilësinë e stafit akademik efektiv, ku nga 8 PAE vetëm 3 pedagogë nuk kanë gradën shkencore "Doktor"; dhe PAK janë 3 nga të cilët 2 nuk kanë gradën shkencore "Doktor" në vitin akademik 2017- 2018. Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë si një departament i ri ka 7 PAE nga të cilët 3 pedagogë kanë gradën shkencore dhe nuk ka të angazhuar PAK në vitin akademik 2017-2018

Pedagogët e brendshëm, po ashtu si në RVB, rezultuan të grupuar në 3 fusha (bërthama studimi):

- a. Shkencë politike
- b. Administrim publik
- c. Teoritë e integritimit

Në një hark kohor prej gjashtë vitesh që prej akreditimit të parë, Programi duket se i ka zbatuar rekomandimet e këtij akreditimi, duke e rregulluar ndjeshëm raportin PAK/PAE, nëpërmjet kualifikimit të pedagogëve ekzistues.

Megjithatë Departamenti i Administrimit publik dhe Formimit bazë, megjithëse i ri, duhet fuqizuar akoma më tej. Ai duhet të ketë edhe pedagogë të jashtëm, ndoshta nga administrata publike, të cilët me eksperiencën e tyre, mund t'i sjellin një vlerë të shtuar këtij departamenti.

Në këtë drejtim, gjendja e konstatuar në institucion reflekton një frymë të mirë bashkëpunimi mes drejtuesve të IAL-së dhe pedagogëve të brendshëm, në funksion të kualifikimit të këtyre të fundit. Gjendja e konstatuar në Institucion me Informacionin e dhënë në RVB rezulton të jetë e njëjtë, me disa ndryshime të lehta, jo thelbësore për procesin e akreditimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

~~Vendimi I Senatit të IJMSH nr 6/1, datë 19.05.2017 mbi organizimin e programeve të studimit nga njësitë përgjegjëse në përputhje me strukturën e miratuar.~~

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e

ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike është përgjegjës për realizimin e programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profile. Sipas RVB, përgjegjës kryesor për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave Politike. Gjatë vizitës në vend, GVJ ju kontaktua nga Përgjegjësi i Departamentit se programi i studimit në vitin akademik 2017-2018 organizohet nga dy Departamente. Në RVB nuk flitet fare për Departamentin e Administrimit Publik dhe Formimit Bazë.

Në këtë program studimi, në të dy departamentet e tij angazhohet personel akademik, personel ndihmës mësimor-shkencor dhe personel administrativ. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbime në zhvillim të institucionit, këshillim për studentët dhe detyra administrative. Personeli akademik ndahet në personel akademik efektiv (PAE) dhe personel akademik me kontratë (PAK). Personeli akademik me kontratë përbëhet nga stafi akademik i jashtëm dhe lektorët e ftuar sipas tematikave të zgjedhura. Në programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative në të dy profilet e tij, angazhohet kryesisht personel akademik efektiv i UMSH, duke përmbushur tërësisht dispozitat ligjore në fuqi, si dhe detyrimin e lënë nga akreditimi i mëparshëm. Të dy Departamentet që organizojnë dy profilet e programit Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative kanë në përbërjen e tyre 7 dhe 8 anëtarë si personel akademik efektivë nga të cilët 3 anëtarë të personelit akademik efektivë me gradë shkencore, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

Fakulteti dhe dy Departamentet angazhohen drejtpërsëdrejti dhe me përkushtim në realizimin e programit të studimit mbështetur edhe nga personel akademik i Fakulteteve dhe Departamenteve të tjera të UMSH, në fushat përkatëse sipas lendëve të planit mësimor. Ngarkesa e tyre shkon mesatarisht në 3-4 lendë, me një ngarkesë deri në 270 orë mësimore, relativisht e lartë, në situatën që stafi akademik angazhohej edhe me detyra administrative si në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, apo Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, Tutorazhin për studentët, etj. Pedagogët në proces doktorature kanë ngarkesa më të ulëta. Personeli akademik është në numër të ekuilibruar me personelin administrativ që mbështet dhe lehtëson procesin mësimor dhe kërkimor.

Departamentet për të plotësuar nevojat në realizimin e programit të studimit, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore, përcaktojnë para fillimit të çdo viti akademik kërkesat për personel akademik. Kërkesa për rekrutimin e stafit akademik pasi miratohet nga Dekani dhe Rektori, publikohet on-line në faqen zyrtare të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", në median elektronike dhe të shkruar ([www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al)). Personeli akademik përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës nga një komision i veçantë, ku marrin pjesë Rektori/ Dekani dhe/ose përgjegjësi i departamentit dhe një përfaqësues i Qendrës "Mesdheu". Insitucioni disponon një bazë të dhënash të personelit efektiv dhe me kontratë.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.

Referuar RVB faqe 17, Tabelës me të dhenat e personelit në aneks, pas verifikimit gjatë vizitës në institucion, konfirmohet stafi akademik i angazhuar në programin e studimit, duke përmbushur rekomandimet e akreditimit të vitit 2012.

Të dhënat e detajuara për të gjitha vitet akademike nga akreditimi i parë për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit Bsc në Shkenca Politike e Administrative jepen në Aneks.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (Referoju Tabeles se Planit ne aneks)

Këshilli Shkencor i Programit të studimit përbëhet nga tre pedagoge me titullin Prof.Assoc. Drejtuesja e kësaj njësie është edhe drejtuese e Këshillit Drejtues të Programeve Bachelor dhe Master Shkencor në

Shkenca Politike, edhe drejtuese e NJSBCZHK. që lehtësisht siguron monitorimin e standardeve të cilësisë në hartimin e kurrikulave dhe syllabuseve si edhe në zbatimin korrekt të tyre.

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotësuar Tabela nr.1 në Aneks nga verifikimi i tabelave të RVB)

Në vitin akademik 2017-2018, raporti PAE/PAK është në favor të PAE për të dy profilet:

Referuar planit mësimor të paraqitur në faqen 44, 45 dhe 46 të RVB ku paraqitet plani mësimor i lidhur me personelin akademik vërehet se:

Në programin e studimit Bsc në Shkenca Politike e Administrative në të dyja profilet e tij janë angazhuar 20 personel akademik i brendshëm (19 personel akademik efektiv dhe 1 personel administrativ) dhe 2 personel akademik i jashtëm (PAK)

Në lidhje me tabelën e stafit akademik të angazhuar në programin Bachelor gjatë vitit akademik 2017-2018 ajo tabele ka disa pasaktësi, si z. Alqi Naqellari Dekan, kur, në fakt, është Z. Përparim Kabo, ndërsa tek pedagogët e jashtëm ka emra që nuk kanë vazhduar në vitin akademik 2017-2018 si Z. Enian Lamçe i dërguar nga MEPJ-ja diplomat në Sh.B.A. dhe Znj. Brikena Balli

Personeli administrativ në mbështetje të tyre përbëhet nga 12 persona staf efektiv i UMSH, sipas RVB-së, ndërkohë që nuk jepen të dhëna të tjera në lidhje më ta.

- Të dhënat sipas gjinise (Sipas tabelës në aneks)

Nga të dhënat sipas gjinisë rezulton që në profilin Shkenca Politike ka 9 pedagogë nga PAE që janë gra dhe 11 janë burra, kurse nga PAK ka vetëm 4 burra. Profili Administrate Publike ka angazhuar 13 PAK gra dhe 2 PAE. Pra ruhet një ekuilibër edhe gjinor me rreth 60% gra të stafit akademik.

- Të dhëna sipas moshës së personelit (Sipas tabelës në aneks)

Nga takimet në UMSH me stafin akademik na rezulton një kombinim i grupmoshave 30-40 me ato 50-60 tek personeli akademik efektiv. Titullarët afër moshës së pensionit kanë përgatitur dhe mbështetur pasardhësit, duke garantuar vijimësinë e suksesit të programit të studimit.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontratat e punës përgjithësisht ishin të rregullta, me ndonjë pasaktësi të vogël aty këtu. Përsa i përket kontratës të punës tip të depozituar edhe në sistem, kemi të bëjmë me disa elementë të pa specifikuar qartë aty:

- E drejta e stafit për një ditë pushim në javë. Dita e pushimit është e shprehur në orë dhe aty thuhet se pedagogu punon nga e hëna në të djelë: Kjo mund të lerë hapësirë për keqinterpretime.
- Në kontratë thuhet se mbi-norma do të paguhet, por nuk specifikohet se sa do të jetë kjo pagesë në orë.

Dosjet e pedagogëve qenë të rregullta dhe të plota. Kontratat e punës gjithashtu qenë të rregullta. Hartimi i kontratave të punës duhet bërë në mënyrë paksa më favorizuese për pedagogët, në mënyrë që ata të japin maksimumin në përkushtimin e tyre në mësimdhënie e në detyrat e tjera të ngarkuara në institucion.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Pedagogët e brendshëm dhe ata me kontratë janë të përzgjedhur me kujdes, me qëllimin për të ofruar një mësimdhënie cilësore, dhe nga ana sasiore një staf administrativ prej 12 personash gjithsej duket se ka plotësuar kërkesat në drejtim të tij nga stafi akademik dhe studentet.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni ndjek një procedurë ligjore transparente (thirrja publikohet fillimisht në ëeb-in e IAL-së) dhe kriteret për rekrutim hartohen në bazë të dispozitave ligjore si edhe kërkesave specifike të departamentit.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë për vitin akademik 2017-2018 është konkretisht gjithsej 30 Personel akademik I brendshëm, ndërsa 2 janë PAK. Përmbushja e kriterit është 93% të personelit.</p> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore për rekrutimin e personelit. Pas një fazë të parë të mbledhjes së aplikimeve, kandidatët i nënshtrohen një konkursi të rregullt në IAL. Zyra e burimeve njerëzore përgjegjëse për bazën e të dhënave disponon një bazë të kënaqshme të dhënash për të gjithë proceset e rekrutimeve të mëparshme.</p>
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor” ose titullin akademik “Docent”.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Burimeve njerëzore, disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program e të personave përgjegjës për organizimin e programit.</p> <p>Institucioni e realizon këtë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Listës së plotë të PAE/PAK</li> <li>• Listës së plotë të personelit ndihmës mësimor-shkencor</li> <li>• Personelit administrativ.</li> </ul> <p>Thirrjet për rekrutimin e personelit akademik publikohen në Qershor e Shtator të çdo viti kalendarik (pra në fund e në fillim të vitit akademik).</p> <p>Titullarët e angazhuar të lëndëve rezultojnë të kenë së paku gradën shkencore Doktor. Në profilin Shkenca Politike rezultojnë 2 PAK me Master, por ata janë të specializuar për dhënien e lëndëve përkatëse.</p>
<b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Në institucion rezulton të realizohen të gjitha veprimtaritë që kanë lidhje me mësimdhënien në mënyrë rigorozë dhe me një seriozitet maksimal.</p> <p>Studentët janë të mbështetur nga një tutor/instruktor i cili i orienton dhe ndihmon në rrugëtimin e tyre, në raportin 1/10.</p> <p>Tutorati duket të jetë shumë efikas edhe në zbutjen e konflikteve mes studentëve dhe pedagogëve/stafit administrativ.</p> <p>Përveç këtyre, Zyrat e Informacionit dhe e Karrierës janë në funksion të plotë të nevojave të studentëve.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjeshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjeshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p>	<p>Institucioni i mbështet pedagogët në kualifikimin e tyre të mëtjeshëm nëpërmjet dhënies së lejes për të ndjekur programe jashtë vendit dhe hera herës edhe me mbështetje financiare në këtë drejtim.</p>

**Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

Ka pasur raste kur IAL-ja ka financuar edhe botime të pedagogëve në fushat e ekspertizës përkatëse të tyre.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Institucioni duket se e realizon më së miri moton e tij të "Gjithçka rreth studentit". Në këtë funksion duket se është edhe interesi i Institucionit për të rritur cilësinë, jo vetëm të kërkimit shkencor, por edhe të mësimdhënies. Sistemi i tutoratit duket tejet efektiv dhe efikas, dhe studentët dukeshin të kënaqur prej tij. Raporti tutor/student është përafërsisht 1/10 për këtë program.
2. Stafi akademik mbështetet në çdo hap në lidhje me rritjen profesionale e atë akademike. PAE-të punojnë në një ambient të kënaqshëm e lehtësues në punën e tyre.
3. Dosjet e pedagogëve qenë të rregullta dhe të plota. Kontratat e punës gjithashtu qenë të rregullta. Hartimi i kontratave të punës duhet bërë në mënyrë paksa më favorizuese për pedagogët, në mënyrë që ata të japin maksimumin në përkushtimin e tyre në mësimdhënie e në detyrat e tjera të ngarkuara në institucion.
4. Departamenti i Administrimit publik dhe Formimit Bazë, megjithëse i ri, duhet fuqizuar akoma më tej. Ai duhet të ketë edhe pedagogë të jashtëm, ndoshta nga administrata publike, të cilët me eksperiencën e tyre, mund t'i sjellin një vlerë të shtuar këtij departamenti.

Standartet përmbushen

**4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mjediset e mësimdhënies të ofruara nga IAL-ja janë bashkëkohore, të rehatshme e shumëfunksionale. Teknologjitë e informacionit, infrastruktura, biblioteka e shërbime të tjera për studentët janë në funksion të tyre e të ofrimit të një shërbimi cilësor në mësimdhënie. Studentëve iu vihet në dispozicion laborator i informatikës dhe sistemi audio-viziv në çdo sallë ku zhvillohen leksione dhe seminare. Ndërtesa ka hapësira të bollshme relaksi si dhe rampa për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuar.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Mjediset për Programin e studimit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

- Salla për leksione (6 me kapacitet 100-120 vende)
- Klasa për seminare (15 me 30-45 vende)
- Salla për aktivitete promovuese (2)
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale (1)
- Laboratorë për lëndët (N/A)
- Laboratorë informatike (1)
- Salla interneti (Kudo ka akses në internet të ofruar nga Institucioni)

- Salla për bibliotekë (1)
- Mjedis për fotokopjime, librari etj (1)
- Zyrë informacioni për studentët (1)
- Nyje hidrosanitare (rreth 4-5)

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin (2)
- Zyra për sekretarinë mësimore (1)
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore (3)
- Zyra për personelin akademik (7)

*Gjendja e godinës e konstatuar në institucion, përgjithësisht përputhet me atë të pasqyruar në RVB dhe këtu sa më sipër.*

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Situata e godinës u vërtetua me një vizitë nëpër institucion.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përputhje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucionin ka siguruar një literaturë të pasur përsa i përket nevojave të studentit dhe atyre të pedagogëve për kërkimin shkencor.</p> <p>Tekstet bazë në shqip ndodhen në bibliotekë në një sasi të konsiderueshme.</p> <p>Gjithashtu, në UMSH ofrohet edhe mundësia për akses në bibliotekën online Questia si edhe në Revistën e përjavshme The Economist.</p> <p>Biblioteka furnizohet rregullisht me tituj të rinj, sipas kërkesave të pedagogëve.</p> <p>Orari i mundësisë për të aksesuar në bibliotekë është i afishuar dhe në përputhje me kohëzgjatjen e orarit në të cilin UMSH-ja rezulton i hapur për publikun</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni vendos në dispozicion të studentëve të gjithë ambjentet e tij, të përshtatura në këtë drejtim.</p> <p>Laboratori informatik iu shërben studentëve në kryerjen më së miri të detyrave të kursit dhe të nevojave të tjera didaktike që ata mund të kenë.</p> <p>Ka një laborator për aksesin në internet dhe punën në kompiuter.</p> <p>Laboratori është i përshtatshëm.</p> <p>Kompiuterat në këtë laborator disponojnë softëare-ët e</p>

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.  
**Kriteri 5** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.  
**Kriteri 6** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

nevojshëm për këto funksione.

Institucioni e ka zgjidhur më së miri çështjen e praktikave profesionale, duke i trajnuar më parë studentët në ambjentet e tij nëpërmjet zyrës së punës Headhunter, e më pas duke i dërguar në instucione të tjera me të cilët ka bashkëpunime në këtë drejtim.

#### **Konkluzione të GVJ:**

1. Të gjitha mjediset mësimore janë pajisur në respekt të plotë të të gjitha kërkesave dhe standarteve shtetërore të cilësisë, me klasa të bollshme dhe të pajisura më së miri. Laboratori informatik, biblioteka me mbi 4000 tituj librash të cilët shtohen në çdo vit akademik, aktivitetet në funksion të studentëve me salla konferencash, mjedise dhe zyra pune të stafit akademik dhe administrative i shërbejnë rritjes së cilësisë së mësimdhënies.
2. Biblioteka dhe salla e studimit ndodhet në katin -1 të godinës dhe është lehtësisht e aksesueshme për studentët, pedagogët dhe studjuesit. Biblioteka siguron literaturë të mjaftueshme në fushën e shkencave sociale, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Standardet e kësaj fushe institucioni i plotëson plotësisht.

UMSH është një institucion që sa i takon infrastrukturës, përmbush plotësisht standardet për studentët dhe stafin akademik në realizimin me sukses të programit të studimit.

## **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka nisur si projekt i OJF "Qendra Mesdheu" regjistruar me Vendim Nr. 411 datë 06.07.2007 në Gjykatën e Tiranës si person juridik me objekt të aktivitetit, shërbimet në fushën e arsimit të lartë privat dhe kërkimit shkencor. Referuar nenit 24 të Statutit dhe nenit 15 të Rregullores Organizative të UMSH, Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjial Administrativ i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi i "Qendra Mesdheu" është autoriteti i cili emëron anëtarët e Bordit të Administrimit, duke iu përgjigjur edhe kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH, nr.80/2015.

Rezultatet e financimit, menaxhimi dhe administrimi i UMSH pasqyrohen në pasqyrat financiare të tij. Institucioni ofron shërbime duke u fokusuar në misionin e tij dhe mban kontabilitet të rregulltë sipas legjislacionit në fuqi. Burimet e financimit janë rritur prej tarifës së studentëve, numri i të cilëve ka ardhur në rritje, duke bërë që pjesa kryesore e financimeve të trefishohet në 6 vjetët e fundit. Burim financimi duket se janë edhe aktiviteti bar-restorant në brendësi të godinës së UMSH dhe konsulentat apo grantet, të cilat natyrisht që pritet të kenë një peshë specifike më të madhe në një universitet në të ardhmen.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje)<sup>1</sup>:

<sup>1</sup>Përqindjet janë të përlogaritura vetëm për vitin e fundit, pra 2017, sipas deklarimeve në RVB, Tabela nr.8, faqe 30.



- Grantet për kërkim (5%)
- Konsulencat, shërbimet (N/A)
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit (85%)
- Sponsorizimet (N/A)
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) (N/A)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj (N/A)
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) (10%)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kostoja për student në UMSH ka ndryshuar ndër vite, duke arritur në 137.000 lekë në këtë vitin e fundit. Pavarësisht kësaj kostoje të lartë, IAL-ja ja del të ofrojë disa bursa për studentët dhe të ketë tarifa konkurruese për regjistrimin e studentëve. Në këto kushte, mund të thuhet se kapacitetet menaxhuese të Universitetit në këtë drejtim janë relativisht të kënaqshme. Ato do të duhet të specializohen më tepër, duke pasur si qëllim rritjen e financimit prej donatorëve dhe programeve/projekteve, në mënyrë që të justifikohet statusi jofitimprurës i kësaj IAL-je.

Tabela 1. Pasqyra dinamike e kostos për student 2011-2017									
ne 000/ leke									
N R	Emertimi	Njësia	Vitet						
			2011- 2012	2012- 2013	2013- 2014	2014- 2015	2015- 2016	2016-2017	2017- 2018
1	Totali financimit	Lekë	98,039	104,016	121,875	162,819	215,443	254,137	288,522
2	Kostoja per student	Lekë /student	257	172	178	102	100	106	137

Kapacitetet menaxhuese financiare

Zyra për Kontabilitet dhe Financë është përgjegjëse për aktivitetin financiar dhe menaxhimin e fondeve në këtë IAL. Aktiviteti i saj auditohet për çdo vit si së brendshmi, ashtu edhe së jashtmi.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Kontrolli nëpërmjet auditimit të brendshëm në UMSH realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm e institucionit.</p> <p>Në bazë të rregullores së brendshme të IAL-së, njësia miratohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij. Raporti i auditit është i përvitshëm dhe rezulton në një pasqyrë të qartë të ardhurave të IAL-së.</p>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b> <b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	

**Kriteri 1** Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

**Kriteri 2** Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

**Kriteri 3** Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Institucioni garanton një raport financiar për të gjitha vitet që prej krijimit të tij. Ai ka arritur të ulë kostot e regjistrimit për student ndër vite, duke dëshmuar jo vetëm një qëndrueshmëri financiare, por edhe një mirëmenaxhim të të ardhurave (kryesisht të tarifave të studentëve).

Institucioni i ka të dokumentuara raportet financiare të tri viteve të fundit.

Universiteti mbështetet pjesërisht nga OJF-ja "Qendra e Medheut" si edhe nga disa aktivitete tregëtare në brendësi të tij. Kapaciteti i tij financiar për gjenerimin e të ardhurave ka shumë potencial, një potencial i cili duhet të shfrytëzohet më mirë në të ardhmen.

#### Konkluzionet e vlerësimit:

1. UMSH është projekt i OJF Qendra Mesdheu dhe në bazë të statutit harton raporte të përvitshme financiare të detajuara të cilat i paraqiten Bordit të Administrimit në çdo vit, duke siguruar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë financiare në gjenerimin e të ardhurave dhe vijueshmërisë së aktivitetit.
2. Zyra për Kontabilitet dhe Financë është përgjegjëse për aktivitetin financiar, menaxhimin e fondeve dhe raportimet në këtë IAL. Aktiviteti i saj auditohet për çdo vit si së brendshmi, ashtu edhe së jashtmi sipas legjislacionit në fuqi. Ajo ndjek zbatimin e të gjithë procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore të UMSH, sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 31.
3. Në mënyrë periodike, Bordi kërkon në bazë të statutit raporte për realizimin e buxheteve duke e përvijuar në mënyrë eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve që zenë 85% të të ardhurave. Përmirësimi i stafit akademik, investimet infrastrukturore të rëndësishme që lidhen me kushtet e punës dhe mesimdhënien, shtimi i fondit të bibliotekës janë indikatorë të përdorimit të fondeve të UMSH.
4. Në këto kushte, mund të thuhet se kapacitetet menaxhuese të UMSH në këtë drejtim janë relativisht të kënaqshme, pasi ka mundësira për rritjen dhe diversifikimin e burimeve të financimit prej bashkëpunëtorëve dhe projekteve kërkimore, me stafin e kualifikuar dhe infrastrukturën që zotëron.

Institucioni i përmbush standardet.

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetevlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Për të garantuar sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, UMSH me statusin e Universitetit tashmë ka ngritur një strukturë të përhershme kryesore si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK). NJSBCZHK informon në mënyrë periodike Dekanatin, Rektoratin mbi rezultatit e përpunimit të anketimeve dhe raportit të vetëvlerësimit të stafit dhe të vlerësimit të titullarit. Ballafaqimi mes këtyre hallkave shkon në drejtim të përmirësimit të mesimdhënies dhe performancës së stafit. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e personelit akademik mbi metodikën e mesimdhënies. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin edhe në njohjen e specifikave të rregulloreve të UMSH dhe në aspekte të organizimit të mësimin.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit:

Nga takimi me anëtarët e NJSBCZHK në UMSH, stafin akademik dhe studentët konfirmohen të dhënat e RVB në lidhje me indikatorët e mëposhtëm për vlerësimin e standardeve të cilësisë.

- Sa anketime kanë bërë me studentët

Zakonisht kryhen 2 anketime në çdo vit akademik me studentët, përkatësisht në fund të semestrit për lëndët e zhvilluara gjatë atij semetri.

- Sa studentë janë anketuar

Anketimi kryhet para sezonit të rregullt të provimeve dhe në të marrin pjesë studentët që janë prezentë dhe dëshirojnë të plotësojnë anketën. Studentët në takimin në UMSH konfirmuan pjesëmarrjen e tyre në anketimin e zhvilluar në fund të semestrit të parë.

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

NJSBCZHK përpunon vetëm ato anketime ku numri i të anketuarve kalon 25% të frekuentuesve të rregullt të lëndës, përndryshe anketa nuk merret në konsideratë për t'u përpunuar. Problematikat i bëhen të njohura stafit akademik dhe studentëve.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

NJSBCZHK zhvillon anketime periodike sipas një plani kalendarik në të cilin programohen vlerësimet që shoqërohen me raporte me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, anketimet e përpunuara, së bashku me raportin e vetëvlerësimit, i kalojnë Rektoratit dhe Dekanatit të cilët zhvillojnë takime konfidenciale me të gjithë stafin e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJSBCZHK informon në mënyrë periodike Dekanatin, Rektoratin mbi rezultatin e përpunimit të anketimeve dhe raportit të vetëvlerësimit të stafit dhe të vlerësimit të titullarit. Ballafaqimi mes këtyre hallkave shkon në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe performancës së stafit. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e personelit akademik mbi metodikën e mësimdhënies. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin edhe në njohjen e specifikave të rregulloreve të UMSH dhe në aspekte të organizimit të mësimin.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Plotësuar Tabela nr. 4, në Aneks)

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë në nivel universiteti janë sipas strukturës hierarkike organizative të UMSH. Struktura e krijuar posaçërisht gjatë këtij viti akademik 2017-2018 për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë është NJSBC dhe NJSBCZHK të cilat kanë në përbërje të tyre staf akademik dhe studentë.

Drejtuësja e kësaj njesie është edhe drejtuese e Këshillit Drejtues të Programit Bachelor në Shkencë Politike dhe Administrative; po ashtu edhe një pedagogë staf efektiv i Departamentit të Shkencave Politike. Këto të dhëna tregojnë që programi Bachelor në Shkencë Politike dhe Administrative e ka probabilitetin të lartë që të zbatohet me rigorozitet monitorimin e standardeve të cilësisë në hartimin e kurrikulave dhe syllabuseve si edhe në zbatimin korrekt të tyre.

Zyra e Burimeve Njerëzore përmes Formularit të Performancës realizon vlerësimin e personelit akademik sipas hierarkisë, ku Dekani vlerësohet nga Rektori, Përgjegjësi i Departamentit nga Dekani, Pedagogët nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe personeli akademik japin vlerësime horizontale për njeri tjetrin dhe duke plotësuar formularët e vetëvlerësimit.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet e kryera u verifikuan përmes vënies në dispozicion të formularit të vetëvlerësimit dhe pasqyrimin në dosjet e personelit të aktivitetit shkencor të çdo pedagogu. Gjatë vitit akademik 2017-2018, NJSBCZHK është marrë specifikisht me adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve nga vlerësimi i jashtëm institucional i bërë gjatë vitit akademik 2016-2017.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Nëpërmjet formularëve të vetëvlerësimit në mënyrë periodike synohet që personeli akademik të ndërgjegjësohet mbi punën dhe performancën e tij dhe për reflektimin në marrëdhëniet me studentët. Ndër tematikat më kryesore nga rezultatet e vlerësimit të personelit akademik kanë qënë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe format e kontrollit të dijeve. NJSBCZHK rezulton të funksionojë duke ruajtur privatësinë, por edhe duke nxitur përmirësimin, ndonëse ky ishte viti i parë i krijimit të kësaj strukture të konsoliduar.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Në institucion na u vu në dispozicion një model formulari vetëvlerësimi dhe një përlllogaritje e performancës të pedagogëve nëpërmjet tabelës së pikëzimit, si dhe një model pyetësori i studentit.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi IL3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pike;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e përvitshëm të punës së tij, nëpërmjet metodave të tërthorta e të drejtpërdrejta.</p> <p>Të gjithë këto elementë, përfshihen në Raportin vjetor të NJSBCZHK-së, i cili iu dërgohet Dekanëve përkatës dhe Rektorit.</p> <p>Pas kësaj, ata ia referojnë pedagogëve pikëzimin përkatës dhe publikojnë rezultatet e përgjithshme që kërkohet të arrihen.</p> <p>NJSBC-ja përpiqet, përgjatë të gjithë vitit të ardhshëm akademik, të realizojë të gjithë rekomandimet e evidentuara nga Raporti.</p> <p>Metodat e tërthorta janë më së shumti të pranishme, në krahasim me ato të drejtpërdrejta, respektivishtnë:</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>sondazhe me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë stafin akademik. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve, si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</li> <li>Përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve si kalueshmëria për lëndë, nota mesatare, etj., të cilat mbahen në sekretari në formate elektronike dhe në regjistra.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Përgjegjësi i Departamentit realizon dëgjime në auditor të zhvillimit të mësimi dhe vëzhgime të praktikës.</li> <li>Rezultatet e testeve, detyrave dhe provimeve të studentëve.</li> </ol>

- c. Cilësia e mikrotezës dhe realizimi në kohë.
  - d. Vlerësimet e veprimtarive kërkimore, botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca.
- Vlerësimet e pedagogëve brenda grupeve kërkimore sipas interesave të përafërta.

### VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

#### Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Institucioni i ka plotësuar standardet institucionale, sidomos pas akreditimit të brendshëm të realizuar përgjatë vitit kalendarik 2017.

Zyra e NJSBCZHK-së dhe ajo e NJSBC-së janë aktive përgjatë të gjithë vitit akademik nëpërmjet monitorimit, mbikëqyrjes, sugjerimeve për përmirësimin e kurrikulave dhe të planeve mësimore.

Institucioni zotëron tashmë një plan pune të qartë për sigurimin e cilësisë së tij të brendshme.

Institucioni përdor kryesisht mekanizma formalë, megjithëse disa mekanizma informalë vërehen në këtë proces: Mosmarrëveshjet studentë-pedagogë zgjidhen kryesisht nëpërmjet bisedimeve informale tutor-studentë apo studentë-përgjegjës përkatës të administratës.

Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që t'i kushtojnë rëndësi programeve të formimit.

Si rrjedhojë e kësaj punë, IAL-ja ka arritur të ketë një manual të Sigurisë së Cilësisë dhe t'ë aplikojë gjithë kryesor të tij përgjatë rregulloreve të brendshme.

#### Konkluzionet e vlerësimit:

1. UMSH i kushton një vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë në çdo hallkë të procesit mësimor e kërkimor. Konsolidimi dhe ristrukturimi i Komisionit ad hoc të Sigurimit të Cilësisë në njësinë e veçantë NJSBCZHK me staf akademik me përvojë në menaxhimin e IAL dhe me studentë është tregues i vëmendjes ndaj cilësisë.
  2. Anketimet periodike të studentëve, vlerësimet sipas hierarkisë administrative nga ZBNJ dhe vetëvlerësimet e stafit akademik janë tregues të rëndësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë për arritjen e objektivave të programit të studimit.
  3. Hartimi i planit vjetor të punës, rregulloreve të brendshme dhe manualeve e lehtëson këtë proces dhe kanë ndikuar në ndërgjegjësimin e stafit për respektimin e standardeve të cilësisë.
- Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie shumëdimensionale, standardi rezulton i përmbushur

### POLITIKAT E FORMIMIT TE STUDENTEVE

#### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni dhe objektivi i programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profile: Shkenca politike; Administratë publike, është në funksion të misionit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë që është i shpallur qartë publikisht në faqen e tij në internet [www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al) “përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit”. Në këtë kontekst edhe programi Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me profile, i përgjigjet kërkesave për studime politike, referuar numrit në rritje të studentëve në këto 6 vjet dhe suksesit të të diplomuarve në punësimin e tyre.

Objekti i këtij programi Bachelor është formimi i profesionistëve me njohuri bashkëkohore në shkenca politike dhe administrim publik. Për realizimin e këtij objektivi, kurikula e programit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative është bashkëkohore dhe e ngjashme me programet Bachelor në universitetet e tjera me të cilat stafi akademik i këtij universiteti është konsultuar gjatë hartimit të saj. Organizimi i vitit mësimor bëhet në dy semestra. Ndërtimi i strukturës së lëndëve mban në një vazhdimësi vertikale njohuritë e fituara në vitin e parë të cilat janë të njëjta për të dy profilet. Ato shërbejnë si themele të përbashkëta për t'u specializuar në dy vitet në vijim për të dy profilet. Plani mësimor ka të harmonizuar edhe në planin horizontal blloqet e lëndëve me njohuri bazë, lëndëve karakterizuese të programit dhe atyre plotësuese. Përtej përmbushjes së numrit të krediteve të moduleve, orëve të leksioneve dhe seminareve, orëve në auditor e jashtë auditorit, rëndësi në konceptimin e programit ka përmbajtja e cila i referohet disiplinave bazë të nevojshme për studjuesit e shkencave politike. Nga diskutimet me stafin akademik, njësinë e sigurimit të cilësisë dhe bibliotekaren kuptuam që rifreskimi me literaturë bashkëkohore përbën një objektivi të punës së tyre i pasqyruar në punën shkencore të stafit akademik.

Programi i studimit mbështetet me cikle leksionesh të ofruara nga titullarët e disa lëndëve si literaturë bazë, në rastet kur nuk ka botime në gjuhën shqipe që depozitohen në bibliotekën e universitetit ku kanë akses të gjithë studentët. Në bibliotekë ka botime në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaj si literaturë ndihmëse, krahas aksesit në librarinë online Questia. Rëndësi i kushtohet informimit të studentëve që në javën e parë të fillimit të studimeve mbi programet e studimit, kohëzgjatjen e tyre, kreditet, lëndët, fakt që u konfirmua nga vetë studentët të cilët ishin të kenaqur nga përvoja e tyre në këtë universitet. Shpërndaria e drejtë e lëndëve gjatë ciklit të studimeve, komunikimi i afërt i stafit akademik dhe atij mbështetës me studentët i shprehur në opinionet e marra nga debatet me stafin akademik, atë mbështetës dhe studentët, lehtësonte procesin mësimor. Pjesëmarrja e tyre në një konferencë shkencore të organizuar në javën e vizitës në UMSH më 1 Qershor 2018, mbi politikat e punësimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm është një tregues me tepër se po realizohen politikat e duhura në formimin e studentëve të shkencave politike, duke iu ofruar atyre jo vetëm libra, leksione në auditore, por edhe debate reale mbi politikat prioritare në vend.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Viti i fillimit të programit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profile është 2011. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” në përmbushje të qëllimit dhe objektivave të këtij programi studimi Bachelor në Shkenca Politike e Administrative synon formimin e një brezi të ri profesionistësh me njohuri bashkëkohore në shkenca politike dhe administrim publik, i cili u konceptua që në fillim me këto dy profile. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profile është përshtatur me ndryshimet që ka pësuar mjedisi universitar i cili ka avancuar në objektivat strategjike të zhvillimit si universitet, të përfshira në planin strategjik dhe të reflektuara në krijimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin e tij. Referuar Vendimit të Senatit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë nr.6/1, datë 19.05.2017 administrimi i programit Bachelor kalon nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në Fakultetin e Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ku profili a. Shkenca Politike ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike; kurse profili b. Administratë Publike ofrohet nga Departamenti i Administrimit Publik dhe

Formimit Bazë. Nisur nga të dhënat e sekretarisë mësimore mbi regjistrimet e studentëve rezultojnë se që nga viti akademik 2014-2015 ata regjistroheshin që në fillim në profile të ndara, pavarësisht se plani mësimor në vitin e parë është i njëjtë dhe specifikat e profileve të tyre dallohen në dy vitet në vazhdim.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
  - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Planin mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Plotësuar Tabelat e Planit nr. 8/1 dhe 8/2 në aneks)

Planin mësimor Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profil: Shkencë Politike (referuar RVB Tabela 10/1 faqe 40) dhe Administratë Publike (referuar RVB Tabela 10, faqe 39) ka të njëjtat lëndë për vitin e parë dhe pastaj ato ndryshojnë në dy vitet e tjera. Në vitin e dytë për profilin e shkencave politike ofrohen dy lëndë me zgjedhje, Filozofi Politike dhe Politika e Jashtme e SHBA, ndërsa për profilin e Administratë Publike nuk ofrohen lëndë me zgjedhje, duke mos përbushur skemën formale të kompozimit të planit mësimor si dhe një nga rekomandimet e akreditimit të mëparshëm. Në program pasqyrohet qartë ndarja e ECTS sipas semestrave dhe viteve, duke thyer standardin që viti akademik të llogaritet me 60 ECTS: viti i parë mbyllet me 56 ECTS, ndërsa viti i dytë me 64 ECTS, viti i tretë me 60 ECTS duke siguruar konform standardeve totalin e programit Bachelor me 180 ECTS. Totali i orëve në auditor të leksioneve është relativisht më i lartë sesa i orëve në auditor të seminareve, ndërkohë që parashikohen orë në auditor për praktikën profesionale që zhvillohen në tre javë gjatë semestrit të fundit të studimeve Bachelor. Nga takimet me drejtuesit dhe stafin e departamentit na u shpjegua se Praktika tani është një lëndë që vlerësohet me notë si gjithë të tjerat, më parë ka qënë pa notë, që realizohet nga profesionistë që merren me drejtimin e agjencive të punësimit, të cilët u ofrojnë orientime studentëve për tregun e punës dhe aftësimin e tyre për kërkimin e punës. Sa i takon formave të mësimdhënies lëksion-seminar për çdo lëndë janë llogaritur kreditet dhe orët e mësimimit në auditor dhe jashtë auditorit si punë e pavarur e studentit, e cila ka një peshë specifike me 20 orë në auditor më të lartë për profilin Administratë Publike, kur kjo është një degë me orientim më praktik sesa profili Shkenca Politike.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit në RVB jepet si më poshtë:
  - Për lëksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
  - Për Seminaret 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
  - Për Laboratoret \_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
  - Për Praktikën lëndore \_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
  - Për Praktikën Profesionale 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit
  - Provimi përfundimtar 1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit

Dërkohë që ndryshimi i krediteve të një lëndë përcaktohet si për orët e lëksioneve dhe ato të seminareve, ndryshimi është i vogël në lidhje me orët që harxhohen në auditor për lëksionet dhe seminaret. Ajo që bën përshtypje është ndryshimi i vogël në lidhje me orët që harxhohen në auditor për seminaret, ku puna e pavarur e studentit duhet të kishte një ngarkesë më të madhe. Praktika Profesionale të bën përshtypje me ngarkesën e lartë të orëve në auditor që thyen konceptin e praktikës si të tillë. Nga vizita në UMSH kuptuam që ajo zhvillohej me studentët e vitit të tretë çdo ditë të premte ora 9:00-12:00 am në formën e lëksionit të hapur nga një ish student i UMSH, që tashmë drejtonte një agjenci private punësimi dhe ndante me studentët përvojat e suksesit në punësim. UMSH kishte hartuar edhe Rregulloren të Praktikës.

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Ndryshimet në planet mësimore janë parashikuar të realizohen dhe propozohen nga Departamenti deri në 15 Maj të çdo viti akademik, duke kaluar në miratim nga Dekanati dhe Senati i UMSH. Megjithatë plani mësimor duket i ngurtësuar, pa ndryshime në 6 vite akademike nga 2012-2017. Po ashtu ka mungesë fleksibiliteti referuar faktit që nuk ka të parashikuara lëndë me zgjedhje në profilin Administratë Publike. Nga bisedat me stafin akademik të diplomuar në universitetet evropiane u theksua se kryesisht viti i parë ka lëndë bazike të fushës së studimit dhe në vitet në vijim ka opsione lëndësh me zgjedhje. Po ashtu, edhe nga diskutimet me studentët u evidentua nevoja për më tepër lëndë me zgjedhje, veçanërisht në fushën e njohurive ekonomike, pasi një pjese të studentëve u lidhej me punësimin e tyre. Në planin mësimor për këtë program studimi mbeten për t'u reflektuar rekomandimet e akreditimit të parë, pasi vetëm në profilin Shkencë Politike janë përfshirë të paktën dy lëndë me zgjedhje, ndërsa në profilin e Administratës Publike ky element mungon. Fleksibiliteti i zgjedhjes së lëndëve mund të influencojë edhe në tërheqjen e studentëve të rinj dhe me rezultate të larta, që është dhe një nga rekomandimet e akreditimit të parë.

Nga shqyrtimi i planeve mësimore të periudhës 2012-2018 nuk duket se ka pasur ndonjë ndryshim krahasuar me programet e licensuara, sikurse paraqitet në RVB, faqe 44 Tabela 12. Zëvendësimi i lëndës "Statistikë" e semestrit të dytë me 8 ECTS me lëndën "Bazat e Shkencës Politike" nuk duket në ndonjë nga planet mësimore të periudhës 2012-2018 që konsultuam në dokumentacionin e ofruar zyrtarisht nga UMSH për procesin e akreditimit.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotësuar Tabela nr. 9/1, 9/2 në Aneks)

Referuar RVB Tabelës nr.8 dhe Tabelave nr.9 në aneks të përgatitura bazuar në planet mësimore të periudhës 2012-2018 dhe takimeve me stafin akademik në UMSH, duket qartë një lidhje e ngushtë mes kualifikimit të stafit akademik dhe lëndëve të përcaktuara në planin mësimor. Në vitin akademik 2017-2018, personeli akademik efektiv mbulon pothuajse gjithë programin Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative, me përjashtim të 2 lëndëve që ofrohen nga personel akademik i jashtëm në profilin Shkenca Politike dhe 3 lëndëve në profilin Administratë Publike. Realizimi i planit mësimor me pjesëmarrjen e pedagogëve nga departamente të tjera është një zgjedhje e mirë, pasi dihet që stafi akademik i brendshëm është më i përgjegjshëm në përmbushjen e objektivave dhe kontrollin e standardeve të cilësisë. Ngarkesat mësimore gjenden të pasqyruara në planin mësimor me pedagogët përkatës për çdo lëndë, konfirmuar nga takimet me ta, mbështetur në Regulloren Organizative të UMSH dhe Regulloren e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset e lëndëve janë standard nga forma dhe në krye të tyre në dokumentin e UMSH të hedhur në sistemin e ASCAL ishte Vendimi i Departamentit i Tetorit të çdo viti akademik për miratimin e syllabuseve që ishin hartuar në Shtator të po atij viti. Në hyrje të syllabusit jepet një përshkrim i përgjithshëm i lëndës, detajohet ngarkesa në kredite si dhe përcaktimi nëse lënda është e detyrueshme apo lëndë me zgjedhje.



Element bazë i syllabuseve janë objektivat e lëndës, të cilat shpjegojnë mënyrën sesi studentët do të pajisen me njohuritë e duhura për atë çfarë lënda ka në përmbajtjen e saj. Elementë të tjerë janë format dhe metodat e mësimdhënies, duke filluar me leksionet në auditor, leksionet e hapura me personalitete dhe ekspertë të fushave të caktura, diskutime, debate gjatë seminareve të programuara. Komponenti i fundit i syllabusve është ndarja e temave që do të trajtohen çdo javë si dhe literatura e përdorur. Secila temë është e ndarë në nëntema mbi të cilat zhvillohet trajtimi teorik i ndërthurur me praktikën. Nga vizita në UMSH rezultoi që stafi akademik ishte i familjarizuar me kërkesat e formatit të ri të syllabuseve të shpallura në vitin 2018 nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për standardizimin e syllabuseve, me të cilat ishin angazhuar t'i rimodelonin. Të gjithë elementët e kërkuar më poshtë janë të pasqyruar në syllabuse.

Formatimi i tyre mbante këtë renditje:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Përshkrimi i lëndës
- Objektivat
- Format dhe metodat e mësimdhënies së lëndës dhe raportet midis tyre
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Format e vlerësimit të studentëve
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik

Fakti që syllabuset miratohen çdo fillim viti nga Departamenti dhe që ato rishikohen çdo vit, sipas bisedës me stafin akademik, është një përvojë e mirë e UMSH. Duke u njohur me çfarë tematikash trajtohen në syllabuse të ndryshme, profesorët shmangin përsëritjet e panevojshme dhe bëhen komplementarë në njohuritë që ofron çdo lëndë.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Ndërsa forma e syllabuseve është e njejtë, në përmbajtje ato ndryshojnë nga njëri-tjetri në varësi të lëndëve dhe specifikave që ka secila prej tyre. Analiza e cilësisë së syllabuseve realizohet mbi bazën e diskutimeve të veçanta që u bënë gjatë vizitës në UMSH me të gjithë personelin akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi, të cilët ishin të familjarizuar me lëndët e tyre dhe të orientuar për të përfshirë në syllabuse informacione të fundit të lidhura edhe më punën e tyre kërkimore doktorale/post doktorale. Po ashtu, nga diskutimi me studentët kuptuam që këto elementë të syllabusit nuk ishin thjesht formale, por ato zbatoheshin në procesin mësimor, duke realizuar një aktivizim të studentëve në grupe të vogla dhe diskutime në auditor me të ftuar mbi çështje aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare, si pjesë e metodave interaktive së punës së pedagogut. Ngarkesa mësimore është pjesë detyruese e komponentëve të syllabusit, në të cilën realizohet përputhja e orëve mësimore me ato të përcaktuara në programet mësimore. Detyrimet për studentin janë gjithashtu të përcaktuara në syllabus me qëllimin, që të mundësohet informimi i studentëve mbi detyrimet që ata kanë kundrejt lëndës. Forma e vlerësimit të studentëve duket e unifikuar për të gjitha lëndët, duke e ndarë vlerësimin në përqindje: konkretisht 70% të lëndës e përbën nota përfundimtare; 20% punimi i eseve dhe 10% frekuentimi në leksione dhe seminare. Një përqindje me e madhe mund t'i lihet frekuentimit dhe pjesëmarrjes së studentëve që të jenë prezentë gjatë të gjitha orëve në auditor, pasi në nivelin Bachelor kjo është e rëndësishme, pjesëmarrja në ndjekjen e leksioneve dhe seminareve që, referuar Rregullores së UMSH, duhet të jetë në masën 75% të lëndës. Për rrjedhojë ajo nuk mund të përbëjë vetëm 10% të vlerësimit. Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse me botime të autorëve vendas dhe të huaj është një nga pikat më të forta të syllabuseve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga takimi me titullarët e UMSH morëm Vendimin NR.6/1, datë 19.05.2017, të Senatit të UMSH për Organizimin e programeve të studimit, ku programi Bachelor në Shkenca Politike organizohej nga:  
 2.b.ii. Departamenti i Shkencave Politike, profili Shkenca Politike  
 2.b.iii. Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, profili Administratë Publike

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi Bachelor në Shkenca Politike e Administrative është akredituar për herë të parë në vitin 2012 dhe ky është riakreditim. Programi organizohet në module dhe është i vlerësuar në kredite, (ECTS) të detajuara madje për leksionet dhe seminarët brenda një lende;</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 56 kredite për vitin e parë; 64 ECTS për vitin e dytë dhe 60 kredite në vitin e tretë duke siguruar në tre vjet 180 ECTS. Këtu mund të ketë vend të rivlerësohet numri i krediteve në 60 ECTS për çdo vit.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p>	<p>Programi Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profile: Shkenca Politike dhe Administratë publike në këtë vit akademik, 2017-2018, ofrohet nga dy departamente: Departamenti i Shkencave Politike dhe ai i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë. Nga takimet në universitet provuam se ata ofrojnë gjithë informacionet e kërkuara nga studentët, të vendosura edhe në webin e tyre për përmbajtjen e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike e Administrative, me dy profilet e tij, që përmbush kërkesat e standardeve. Studentët informohen në mënyrë të detajuar si nga stafi akademik e administrativ, por veçanërisht nga Tutorët përkatës për detyrimet e pjesëmarrjes dhe ato akademike.</p> <p>Departamentet japin informacionet e nevojshme për lëndët që në javën e parë të fillimit të semestrit, sikurse doli nga takimi në universitet me stafin akademik dhe me studentët e profilit shkenca politike. Departamentet ofrojnë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore e cila përmbush standardet; orët në auditor duken të mbingarkuara veçanërisht për lëndë si praktika; frekuentimi i studentëve evidentohet nga regjistrat - vendosja e mungesave në disa lëndë bëhej, në disa të tjera jo - të verifikuara gjatë takimit me sekretarinë mësimore në UMSH; studentet që nuk kishin frekuentuar në lëndë të caktuara, nuk figuronin as në procesverbalet e provimit, një procesverbal provimi kishte vetëm dy studentë kalues.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Departamentet japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë. Secili prej pedagogëve dërgon me email te studentët syllabuset përkatëse me të gjitha sqarimet specifike që nevojiten përsa i përket pjesës shkencore të lëndës, frekuentimit dhe mënyrës së vlerësimit. Çdo pedagog për lëndën që zhvillon realizon një orë në bibliotekën e UMSH për t'i familjarizuar studentët me këndin e Shkencave Politike dhe kërkimin në literaturë.</p>

Sa për praktikat e studentëve, të konfirmuara nga takimet me ta në UMSH, institucioni ka marrëveshje me mjaft subjekte publike dhe jo publike, të qeverisjes qendrore dhe vendore, kryesisht me Bashkitë e Gjirokastrës, Sarandës, Durrësit dhe Tiranës për praktikat e studentëve.

### Konkluzionet e vlerësimit:

Misioni dhe objektivi i programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me dy profile janë konform strategjisë së institucionit. Plani mësimor është i organizuar në lëndë/module me kreditet përkatëse. Madje edhe brenda një lënde kreditet ndahen mes leksioneve dhe seminareve me orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit. Ndonëse në RVB, faqe 48, shkruhet se gjatë një viti sigurohen 60 kredite, nga tabelat e detajuara të planeve mësimore në periudhën 2012-2018 konstatohet se programi për vitin e parë ka 56 ECTS dhe vitin e dytë 64 ECTS. Nga përmbajtja, plani mësimor duket i ngurtësuar pasi nuk ka bërë ndryshime në 6 vite, megjithë ndryshimet e stafit akademik efektiv që është rritur në sasi dhe kualitet. Plani mësimor ndahet sipas disiplinave të formimit të përgjithshëm, formimit karakterizues dhe disiplinave të ngjashme duke realizuar një ndërthurje harmonike të tyre, por që ende mungon kategoria e lëndëve me zgjedhje. Studentëve u jepet një informacion i detajuar për programin, për kohëzgjatjen, ngarkesën si numër lëndësh dhe pedagogët që e zhvillojnë atë, për kornizën kurrikulare, për format e mësimdhënies dhe kontrollit të saj, për literaturën bazë të detyrueshme dhe atë plotësuese. Java e informimit i paraprur të gjithë vitit akademik, javë në të cilën studentët aftësohen për mënyrën e marrjes së informacionit, kontaktet me pedagogët, me sekretarinë mësimore dhe hapjen e e-maileve të tyre zyrtare të UMSH-së. Orari, syllabuset dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm bëhet i njohur në disa nivele, nga sekretaria, pedagogët respektivë, tutorët dhe nga webi i UMSH, ku aksesi në internet është i pandërprerë.

**Nga analiza e standardeve të kësaj fushe gjykojmë se institucioni i plotëson kryesisht standardet.**

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënies realizohet sipas standardeve në mjedise të pajisura me të gjithë logjistikën e nevojshme. Mësimdhënia e lëndëve të veçanta që përmban programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative organizohet në formën klasike leksione dhe seminare. Nga takimi me stafin akademik dhe studentë kuptuam që në pesë vitet e fundit ishin futur forma të reja të mësimdhënies si Kinemaja politike, që gjerësisht përdoret në universitetet amerikane. Pedagogu zgjedh një film që trajton tema politike dhe diskuton me studentët për konkretizimin e ideve politike, dhe ky projekt vazhdon për 10 javë. Salla në katin e parë ishte mëse e përshtatshme për një veprimtari të tillë. Në lëndët e programit të studimit është aplikuar zhvillimi interaktiv i leksioneve, duke ftuar personalitete të fushës, leksione të hapura madje edhe konferenca me tema të përkohshme të aktualitetit, përpjekje që e bën procesin mësimor të jetë sa më tërheqës dhe i kuptueshëm, konkret. Studentët diskutojnë mbi këto çështje kryesore duke shkëmbyer mendime me njëri-tjetrin nën moderimin e pedagogut përgjegjës.

Ngarkesa mësimore është e ndarë sipas normave mbi ngarkesën mësimore që duhet të ketë çdo pedagog, ndonëse përcaktimi prej 270 orësh fizike në auditor sipas Zyrës së Burimeve Njerëzore duket i lartë në krahasim me standardet për IAL publike tek 150 orë faktike në auditor, maksimumi deri në 225 orë. Shpërndarja e lëndëve në departament është bërë duke u bazuar në kualifikimin dhe fushën e studimit të pedagogëve me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies realizohet në forma të larmishme duke marrë feedback nga titullarët si në ndjekjen e leksioneve nga Përgjegjësi i Departamentit; nga Dekani dhe Zyra e Burimeve Njerëzore përmes formularëve të vlerësimit; janë marrë

*[Handwritten signatures]*

mendime nga studentët përmes anketimit për lëndët e zhvilluara gjatë semestrit dhe përmes formularëve të vetëvlerësimit të personelit akademik. Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë është i dukshëm, jo vetëm në vlerësimin e procesit mësimor, por edhe në angazhimin në punë administrative, si sekretaria, laboratorët, në panairin e ideve që zhvillohet çdo vit, etj.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Plotësuar Tabela nr.8 e Planit në aneks):

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Referuar RVB, faqe 50, dhe diskutimeve me personelin akademik dhe studentët, format kryesore të mësimdhënies janë pasqyruar sipas standardeve në Tabelat nr 8/1 dhe 8/2 në aneks. Aty dominojnë leksionet me orët më të shumta në auditor, për më tepër për profilin e Administratë Publike (1940), që në krahasim me profilin Shkenca Politike (1925) mund të kishte më pak orë në auditor dhe më tepër orë praktika, bazuar në mundësitë e bashkëpunimeve të shumta që UMSH ka me subjekte publike qendrore e vendore. I njëjti arësyetim vlen edhe për lëndën Praktika që ka 360 orë në auditor.

Format e kontrollit të njohurive

Në klasifikimin e formave të kontrollit të njohurive që përshkruhen në syllabuset e lëndëve vihet re një klasifikim tepër i thjeshtëzuar i tyre në:

- 1) Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive që zë 10% të vlerësimit, ndërkohë që për nivelin Bachelor ky është një komponent i rëndësishëm, ku leksionet dhe seminarët në auditor zenë një peshë specifike të madhe në format e mësimdhënies. Vendosja e standardeve të pjesëmarrjes së studentëve në mbi 70% të orëve të mësimin në seminare ka këtë domethënie, që duke qenë prezentë, ata kanë mundësi të rrisin nivelin e të nxënës, prandaj ky element mund të ishte më i lartë.
- 2) Punimi i eseve apo detyrës së kursit 20%;
- 3) 70% të peshës specifike të vlerësimit e mban provimi final. Mendojme se duhet reduktuar, duke vendosur vlerësime për projektet e studentëve në panairin e ideve, që sikurse na u përshkrua është veprimtari e përvitshme, apo për debatet në orën e kinemasë, etj.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit shkencor të departamentit në nivel Bachelor në Tabelën nr. 16, faqe 50 te RVB nuk pasqyrohet qartë. Aty është evidentuar vetëm pjesëmarrja e 46 studentëve në aktivitete të organizuara në nivel Universiteti, por jo në nivel Departamenti. Kjo mund të lidhet me faktin që departamentet respektive janë njësi të reja në përbërje të Fakultetit të ri të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimet në këtë program Bachelori në Shkenca Politike e Administrative me dy profile janë bërë konform Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë” që ka zëvendësuar Ligjin e vitit 2007. UMSH është tepër proaktiv në promovimin e institucionit dhe tërheqjen e studentëve, veçanërisht kjo bëhet edhe më e domosdoshme me procedurat e reja të pranimit të tyre në mënyrë të centralizuar për gjithë sistemin publik e privat të arsimit të lartë në Shqipëri. Takimet në shkollat e mesme në të katër anët e vendit, java e hapur e UMSH për të pritur studentët e interesuar duke iu ofruar gjithë informacionet mbi procedurat e pranimit të studentëve, kanë mundësuar rritjen e numrit të studentëve nga viti në vit. Nga të dhënat e marra në sekretarinë mësimore duket se është e rëndësishme edhe cilësia në hyrje e studentëve, të cilët kanë ardhur edhe nga jashtë vendit, kryesisht nga Greqia, pasi edhe stafi akademik ka ardhur i diplomuar nga universitetet greke. Sigurisht që numri i studentëve në hyrje është më tepër se dyfishi i atyre në dalje të diplomuar në këto 6 vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve nuk mund të kalojë dyfishin e kohës normale të studimeve Bachelor që është 3 vjet. Kalueshmëria e studentëve lidhet në shumicën e rasteve, sipas statistikave, me mosfrekuentimin e tyre, përderisa një pjesë e mirë janë të punësuar në biznese private apo vijnë nga jashtë Tiranës. Shumica e të diplomuarve janë punësuar në profesione të përafërta, sidomos nga institucionet ku kanë zhvilluar praktikat. Komunikimi me ish-studentët vazhdon përmes rrjetit Alumni, madje në disa raste ata i janë bashkuar projekteve të UMSH edhe pas diplomimit, si në rastin e E. Ilirjanit me agjencinë e punësimit the Headhunter Shpk. Ajo çfarë konsiderohet si një objektiv për t’u arritur është ndërkombëtarizimi dhe rritja e reputacionit të UMSH për të tërhequr studentë dhe profesorë nga shtetet e tjera të Mesdheut për zhvillimin e një qasjeje rajonale.

#### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit për universitetet private janë unifikuar me Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH” dhe UMSH i ka respektuar këto rregulla. Në dy vitet e fundit akademike 2016-2017 dhe 2017-2018, pranimi në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë është realizuar sipas sistemit të përqëndruar në nivel kombëtar, ndërsa më parë pranimi realizohej sipas studenteve që zgjidhnin të regjistroheshin në IAL private, pa pasur nevojë të hynin në rankimin kombëtar. Përzgjedhja e kandidatëve për pranim në çdo fakultet bëhet nga një komision i caktuar nga Dekani, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur sipas akteve ligjore dhe administrative të institucionit dhe miratohen nga Senati Akademik.

Studentët e rinj aplikantë informohen nëpërmjet webit të UMSH dhe sekretarisë. Në javën e parë të studimeve organizohet “Java e Informimit” si javë orientuese për studentët e rinj. Në procedurën e pranimit të studentëve u jepet informacion për programin, për ngarkesën si numër lëndësh dhe pedagogët që zhvillojnë atë, për format e mësimdhënies dhe kontrollit të saj, për librat që përdoren në procesin e mësimdhënies, për literaturën që përdoret edhe on-line dhe se si do ta gjejnë atë, si dhe syllabuset për çdo lëndë. Studentëve u vihet në dispozicion një email personal ku u dërgohet përsëri udhëzimi nga tutori që është përgjegjës për ta, duke specifikuar të drejtat dhe detyrimet e tyre. Rol të rëndësishëm luan dhe ZKSK që i mbështet studentët, jo vetëm gjatë pranimit, por gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të tyre si dhe i orienton ata në mundësitë për kryerjen e studimeve të mëtejshme të Masteri Shkencor dhe Profesional. Nga biseda me një pjesë të studentëve të pranuar, ata konfirmuan se informacionin për të zgjedhur këtë program studimi e kishin marrë nga studentët e diplomuar në UMSH (ALUMNI). Manuali i Studentit është një udhëzues i mirë për çdo student të UMSH.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje për vitin akademik 2016-2017 është rritur për shkak të ndryshimit të procedurave të pranimit referuar Ligjin Nr.80/2015 të Arsimit të Lartë, që vendosi notën mesatare 6 krahasuar me vitet e mëparshme akademike. Ndërsa në dalje, nota mesatare e studentëve përgjithësisht rritet, si pasojë e punës individuale që bëhet me ta nga stafi akademik, sikurse u vërtetua edhe nga biseda me studentët gjatë takimit në UMSH.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Studentë të regjistruar në vitin e parë kanë ardhur duke u rritur deri në vitin akademik 2015-2016 ku është numri më i lartë në 99 studentë, nga 52 studentë të rregjistruar një vit më parë, në 2014-2015. Ky hop është edhe për shkak të prurjeve nga universitetet e tjera private të mbyllura nga Ministria e Arsimit, të cilët kanë ulur cilësinë, referuar notës mesatare në hyrje që zbrit në 6.8, duke vazhduar të jetë edhe më e ulët në 6.19 në vitin në vijim 2016-2017, sikurse edhe numri i studentëve të rregjistruar ulet. Ky është edhe pasojë e efektit të zbatimit të Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë që aplikoi për herë të parë një sistem të centralizuar pranimesh edhe për universitetet private në Shqipëri. Në vitin 2017-2018 ky numër mbetet konstant, në 40 studentë të rregjistruar, duke rritur cilësinë e tyre me notë mesatare 7, në respekt të kriterit hyrës me notën mesatare 6. (Në RVB në tabelën nr.2 të faqes 10 mbi numrin e studentëve ka një pasaktësi, që nuk përputhet me tabelën më pas).

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Studentët e diplomuar në programin Bachelor në Shkenca Politike e Administrative variojnë nga 90% e të regjistruarve në vitin akademik 2012-2013 në nivelin më të ulët të vitit akademik 2016-2017 me kalueshmëri gati 50% dhe notë mesatare 7.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Mobiliteti i studentëve brenda dhe nga jashtë UMSH është evidentuar veçanërisht në vitin akademik 2015-2016 për shkak të prurjeve nga Institucionet e tjera private të mbyllura me Vendim të Ministrisë së Arsimit. Të dhënat e transferimeve në Tabelën nr.12 në aneks provojnë se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë njeh kreditet e përfituara dhe transferon studimet, midis programeve të të njejtit cikël studimi, brenda të njejtit institucion dhe në institucione të tjera. Transferimet lejohen brenda të njejtit cikël studimesh në fusha studimi të njejtja ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve bëhen sipas akteve ligjore të përcaktuara nga Ligji "Për Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH" Nr. 80/2015 dhe në Statutit të UMSH, neni 76. Njohja e plotë ose e pjesshme e krediteve të fituara nga studentët me pëllim vazhdimin e studimeve në UMSH kryhet nga një komision *ad hoc*.

- Të dhëna për punësimin e studentëve

Nje pjesë e studentëve janë të punësuar edhe përgjatë studimeve, ndërkohë që UMSH ju krijon mundësinë e praktikave në institucione të ndryshme publike e private, apo organizata të shoqërisë civile të cilat pas përfundimit të studimeve Bachelor kanë mundësuar edhe punësimin e tyre. Nga takimet në UMSH morëm informacionin se një nga studentët e tyre të diplomuar vite më parë kishte krijuar një organizatë për punësimin e të rinjve, i cili realizonte leksione të hapura gjatë orëve të praktikave për mundësitë e punësimit të të diplomuarve nga ky universitet. Nga të diplomuarit në këtë program, mbi 50% kanë vazhduar dhe

vazhdojnë studimet në ciklin e dytë Master Shkencor dhe Profesional. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës mban kontakte të rregullta me të diplomuarit dhe ka komunikuar me rreth 36% të të diplomuarve (58 student) në këtë program studimi. Një pjesë e studentëve të këtij programi studimi janë të punësuar që në hyrje dhe përgjatë studimeve. Ndërkohë UMSH iu krijon mundësinë e praktikave në institucione të ndryshme publike e private, apo organizata të shoqërisë civile, Në semestrin e fundit, ku pas përfundimit të studimeve u ofrohen edhe mundësi punësimi. Nga takimet në UMSH morëm informacionin se një nga studentët e tyre të diplomuar vite më parë kishte krijuar një agjenci punësimi, The Headhunter Shpk., dhe orientonte studentët në tregun e punës. Bazuar në përvojën e punës me të ai zhvillonte lëndën e Praktikës me studentët.

Numri total të diplomuarve

Nga të dhënat e RVB, faqe 53, Tabela nr.18 rezulton se gjatë periudhës 2011-2017, të diplomuarit nga programi Bachelor ne Shkenca Politike e Administrative në të dy profilet e tij janë 153 studentë, pra gati 50 përqind e të regjistruarve në këtë degë studimi..

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nga të dhënat e RVB, faqe 53, Tabela nr.18 rezulton se gjatë periudhës 2011-2017, të diplomuarit e punësuar zinin rreth 40% të të diplomuarve, nga të cilët të punësuarit sipas titullit të diplomës përbënin rreth 67 përqind të të diplomuarve të punësuar. Këta janë indikatorë të një fillimi të mbarë dhe fakti që UMSH i njëj këto situata, tregon për lidhjet në vazhdimësi të tyre me studentët edhe pas largimit nga universiteti.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Nga të dhënat e RVB, faqe 53, Tabela nr.18 rezulton se gjatë periudhës 2011-2017, të diplomuarit e punësuar jo sipas titullit të diplomës përbënin rreth 19 përqind të të diplomuarve të punësuar.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Të dhëna nga sekretaria mësimore mbi numrin e studentëve të regjistruar respektivisht në dy profilet e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor, si dhe të diplomuarit me notën mesatare në hyrje dhe në dalje për periudhën 2012-2018.

**Aty evidentohet që nga viti akademik 2014-2015 studentët regjistrohen që në fillim të vitit të parë në profile të ndara, që do të thotë në programe të ndryshme Bachelori.**

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbyshja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TE DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor është mundësuar deri në vitin akademik 2015-2016 sipas Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, ndërsa në dy vitet e fundit akademike është bazuar në Ligjin 80/2015 për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare mbi 6 të përcaktuar me VKM.</p> <p>Kriteret e pranimi në ciklin e parë të studimeve janë në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 reflektuar në nenin 50 të</p>

	Rregullores Organizative ku janë përcaktuar modalitete në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve të cilët duan të vazhdojnë studimet e ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profile. Përzgjedhja e kandidatëve për praninë në çdo fakultet bëhet nga një komision i caktuar nga Dekani, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga shqyrtimi i dosjes personale të kandidatit. Kuotat e studentëve që mund të regjistrohen propozohen nga Departamentet dhe miratohen nga Senati Akademik.
--	---

**Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.**

<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët që në javën e parë të fillimit të studimeve informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, organizimin e tij në 6 semestra, dy profile, afatin e përfundimit jo më vonë se dyfishi i kohës normale, pra në 6 vjet dhe me procesin e akreditimit të programit. Kjo javë realizohet në mënyrë të programuar me angazhimin, jo vetëm të personelit akademik e administrativ, por edhe të studentëve nga Këshilli Studentor. Nga biseda me studentët se nga e kishin marrë informacionin e parë për UMSH doli që ishin të diplomuarit nga ky universitet.</p> <p>Vlerësimi nga ana e studentëve organizohet përmes anketimit semestral që kryhet nga NJSBCZHK në bashkëpunim me Departamentet ku studentët japin mendimin e tyre për programin e studimit, cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studentë dhe pedagogë e konfirmuan këtë proces gjatë bisedës me tan të UMSH.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës është një strukturë që funksionon pranë UMSH, e cila drejton dhe mbështet studentët gjatë procesit të formimit universitar, si dhe orienton dhe këshillon ata mbi kërkesat e tregut të punës duke mbajtur kontakte me të diplomuarit, agjencitë e punësimit dhe subjektet e tjera bashkëpunëtoresh të UMSH</p> <p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ndihmon në ofrimin e mundësive që studentët, gjatë kohës së studimeve, të mund të ndërtojnë rrugën për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës. Kjo zyrë përbëhet nga personel akademik nga të dy departamentet përgjegjëse për këtë program dhe studentë.</p> <p>Krahas saj, përmes lëndës së praktikës dhe bashkëpunimeve me institucionet e tjera publike dhe jopublike, për studentët sigurohen informacione në lidhje me mundësitë për punësim.</p>
---	--

**Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.**



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me statistikat vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në rregjistra dhe në format elektronik në sekretarinë mësimore të këtij programi studimi.</p> <p>Institucioni, nëpërmjet sekretarisë së Departamenteve, përgatit statistika vjetore, ku evidentohet numri i studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Gjithashtu, në regjistrin mësimor që përdor pedagogu janë të pasqyruar të gjithë studentët, frekuentimi i tyre gjatë semestrave për lëndët përkatëse, ka një pjesë lëndësh me regjistrin e paplotësuar përfundimisht, ndonëse është fundi i vitit.</p> <p>Departamenti dhe sekretaria i mbajnë të dhënat të përditësuar nëpër rregjistra dhe në formate elektronike për studentët që nga pranimi dhe deri në diplomim.</p>
<p><b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës i ndihmon studentët në orientimin për vijimin e studimeve në ciklet e mëpasme të studimit, për pjesëmarrjen në projektet e UMSH si panairi i ideve, për pjesëmarrjen në aktivitete dhe konkurse kombëtare e ndërkombëtare dhe anketa me të diplomuarit.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në bashkëpunim me organizata të specializuara për politikën e punësimit, orienton dhe këshillon studentët për përzgjedhjen e institucionit ku do të zhvillojnë praktikën, e cila zgjat 3 javë. Institucionet e praktikës mund të jenë nga ato që UMSH ka marrëveshje, apo edhe zgjedhje e lirë e studentit.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>UMSH ndjek politika të mirëorganizuar për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve me parimin “Studenti në qendër”. Kjo u verifikua nga vizita në UMSH, në takimet me studentët dhe personelin, ku reflektoheshin marrëdhënie shumë të mira dhe të hapura bashkëpunimi. Institucioni organizon javën e parë për mirëpritjen dhe dhënien e informacioneve studentëve të rinj që realizohet në mënyrë të programuar me angazhimin, jo vetëm të personelit akademik, por edhe të studentëve dhe personelit administrativ. Përveç studentëve të rinj, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë përfshirjes së të gjithë studentëve në jetën institucionale, nëpërmjet mundësisë së angazhimit në Këshillin Studentor, në Zyren e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe në punë në formën e <del>internshipit. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në bashkëpunim me agjencitë të specializuara për politikën e punësimit orienton studentët për përzgjedhjen e institucionit ku do të zhvillojnë praktikën, duke i ndihmuar në ofrimin e mundësive për t’u integruar lehtësisht në tregun e punës.</del></p> <p>Institucioni i përmbush standardet.</p>	

**KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**10. Kërkimi shkencor**

## Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Me kalimin nga Shkollë e Lartë në Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, kërkimi shkencor merr një rëndësi të veçantë si pjesë përbërëse e veprimtarisë së personelit akademik dhe institucionit, sikurse rezultoi edhe nga diskutimet me drejtuesit dhe stafin akademik. Gjatë vizitës në UMSH biseduam me drejtuesin e Qendrës së Kërkimit Shkencor, një njësi që përbëhej nga dy zyra, atë të Marrëdhënieve me Jashtë dhe atë të Projekteve. Kërkimi shkencor realizohej përmes një rrjeti bashkëpunëtorësh me institucione akademike, të administratës publike dhe organizatave jo publike e private që Qendra Mesdheu kishte siguruar që nga krijimi i saj (Tabela nr.17 në aneks). Kërkimi shkencor kryhet në fushat sipas të cilave janë të organizuara edhe grupet e pedagogëve: Çështje aktuale në fushën e studimeve politike; Zhvillimin e platformave të komunikimit politik; dhe Çështje që lidhen me integrimin europian. Një aspekt i veprimtarisë shkencore është pjesëmarrja e pedagogëve në zbatimin e granteve kërkimore-shkencore të financuara nga universitete dhe institucione të tjera, që zenë 5% të burimeve të financimit të UMSH. Puna shkencore për finalizimin e studimeve të doktoraturës apo postdoktorale është pjesë përbërëse e stafit akademik. UMSH mbështet financiarisht pjesëmarrjen e pedagogëve në udhëtime studimore në universitete dhe institucione të huaja. Botimet e punimeve shkencore të pedagogëve ofrohen nga UMSH Press që deri tani ka botuar 10 numra të Revistës shkencore periodike EUROMEDITERRANEAN (ku mund të publikohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj), kopjet e së cilës i konsultuam në Bibliotekën e UMSH. Stafit pedagogjik si dhe tezat më të mira të studentëve u jepet mundësia për t'i publikuar edhe në International Journal of Euro-Mediterranean Studies.

Departamenti i Shkencave Politike në Bashkëpunim me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare realizon aktivitetin e përvitshëm “Kinemja Politike në 10 javë”. Ky aktivitet konsiston në ndjekjen e dhjetë filmave të përzgjedhur nga pedagogët, iniciativë e kthyer në traditë. Studentë dhe pedagogë analizojnë ndikimin e politikës në kinematografi dhe anasjelltas, si dhe efektivitetin e përdorimit të kinemasë si mjet për të arritur qëllime politike. Krahas pedagogëve, studentët bëhen pjesë në debatin që realizohet pas përfundimit të filmit përkatës.

Krahas aktiviteteve të departamenteve, pedagogët e lëndëve që përfshihen në programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative në të dy profilet kanë marrë pjesë edhe në aktivitetet shkencore të organizuara nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, të tilla si konferenca shkencore e zhvilluar me datë 1 Qershor, 2018 në Tirana Internacional me pjesëmarrjen dhe referimin e profesorëve të huaj dhe atyre nga UMSH mbi zhvillimin e qendrueshëm dhe politikat e punësimit. Rritja e kërkimit shkencor të pedagogëve ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e mësimdhënies si dhe në larinë e literaturës së përdorur. Në takimet e zhvilluara në departament puna kërkimore u evidentua nga secili pedagog dhe ishte e pasqyruar në dosjen e tij personale që na u vu në dispozicion nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Plotesuar Tabelat ne aneks)

Nga takimet në UMSH dhe evidenca mbi aktivitetin shkencor të institucionit për periudhën 2012-2018, del qartë se Departamenti i Shkencave Politike ka një angazhim serioz në veprimtaritë kërkimore shkencore si brenda dhe jashtë vendit. Më konkretisht, disa tregues të matshëm për periudhën 2012-2018 janë pasqyruar në Tabelat nr.15, 16 në aneks, ku Departamenti i Shkencave Politike ka tregues në lidhje me pjesëmarrjen në konferenca shkencore brenda (10) e jashtë vendit (34), në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj (12),

botime të artikujve shkencorë brenda (26) e jashtë vendit (3), monografi (6) dhe pjesëmarrje në programe lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare (3). Po ashtu, Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë ka tregues në lidhje me pjesëmarrjen në konferenca shkencore brenda (17) e jashtë vendit (35), në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj (37), botime të artikujve shkencorë brenda (22) e jashtë vendit (15), monografi (2) dhe pjesëmarrje në programe lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare (2).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga biseda me Rektorin e UMSH morëm evidencën mbi aktivitetin shkencor të njëjësive bazë të UMSH për periudhën 2012-2018, nga e cila evidentohen të dhënat respektive mbi Departamentin e Shkencave Politike dhe Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

**Niveli i kualifikimit të stafit akademik dhe politikat e UMSH në mbështetjen e rritjes së kapaciteteve të tij për kualifikim të vazhdueshëm, duke u ofruar mbështetje financiare si dhe infrastrukturore, janë një nga pikat e forta të këtij institucioni. Në funksion të saj UMSH ka krijuar struktura të posaçme për mbarëvajtjen dhe mbikqyrjen e vazhdueshme të rritjes së aktivitetit shkencor në forma të larmishme, si Qendra e Kerkimit Shkencor dhe një rrjet të gjerë bashkëpunimesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Institucioni disponon një bazë të dhënash me tregues konkret të punës kërkimore që nga konferencat shkencore, botimet në revistat me faktor impakti, duke qenë anëtar i EMUNI, botimet shkencore të stafit akademik, apo dhe të studentëve kanë mundësi të publikohen në *International Journal of Euro-Mediterranean Studies*. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me institucionet publike i kanë shërbyer lidhjes së teorive politike me zhvillimet aktuale duke i ofruar studentëve prekje të aktualitetit, jo vetëm lexim të librave. UMSH ofron infrastrukturën e nevojshme për kërkimin shkencor, si për stafin akademik edhe për studentët. Institucioni i plotëson standardet plotësisht.**

## **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Marrëdhëniet institucionale të bashkëpunimit në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar të UMSH dëshmojnë për një traditë të konsoliduar marrëdhëniesh dhe hapjeje të institucionit si me universitete homologe, ashtu dhe me institucione publike dhe jopublike. Për bashkëpunimin në nivel lokal mund të përmenden Memorandumi i Bashkëpunimit të UMSH me Njësinë bashkiake Nr.1 në Tiranë, me Bashkinë Durrës dhe me Bashkinë Sarandë; në nivel kombëtar bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e Tiranës, Avokatin e Popullit etj. Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe si me Akademinë Diplomatike të Londrës, me Universitetin e Tuzlës në Bosnjë-Hercegovinë; LUM Jean Monnet University, Casamassima (BA), Itali; Universitetin e Qipros; Universitetin e Strugës; Kolegjin Universitar "Biznesi" me seli në Prishtinë etj.

Këto bashkëpunime kanë mundësuar mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel rajonal e ndërkombëtar me pjesëmarrjen në aktivitete e projekte të ndryshme. Në shërbim të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi edhe

me përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit privat në Shqipëri dhe vende të rajonit, ndër të cilat mund të përmenden bashkëpunimin me: Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë të Tiranës; Aleancën e Biznesit të Kosovës; Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë; Shoqatën e Bankave të Shqipërisë; Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit të Shqipërisë etj. Duke pasur prioritet kryesor aftësimin e studentëve në fushën e shkencave politike, janë krijuar mundësi për kryerjen e praktikës mësimore për studentët e programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative në institucione të tilla që kanë realizuar edhe punësimin e tyre pas diplomimit. Po ashtu, marrëdhëniet e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar i kanë shërbyer rritjes së aktivitetit shkencor si në konferenca shkencore të organizuara nga UMSH, ku ishin të pranishëm një pjesë e konsiderueshme e bashkëpunëtorëve.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (plotësuar Tabela nr.17 në aneks)

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike me dy profilet e tij i plotëson kriteret e këtij standardi dhe është në mbështetje të zhvillimit dhe bashkëpunimit me institucionet e huaja duke kërkuar vazhdimisht kontakte të reja, krahas atyre të pasqyruara në Tabelën nr.17 në aneks. Programi i studimit ka përfituar nga marrëdhëniet e bashkëpunimit lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve të stafit akademik, të punës mësimore e kërkimore dhe të praktikave të studentëve. Në këtë kuadër, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka nënshkruar më shumë se 50 marrëveshje bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe jo arsimore në nivel lokal, kombëtar si dhe ndërkombëtar. Në strategjinë e institucionit është zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimeve, veçanërisht me vendet e Mesdheut në realizimin e qëllimeve të Qendrës Mesdheu që ka iniciuar hapjen e UMSH. UMSH në sajë të marrëdhënieve të bashkëpunimit ka mundur edhe punësimin e studentëve. Referuar Tabelës nr.17 në aneks evidentohen bashkëpunimet me çdo institucion që Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë ka kontratë bashkëpunimi dhe specifikohet plani i veprimtarive konkrete të bashkëpunimit.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotësuar të dhenat në aneks)

UMSH ka krijuar rrjetin e partnerëve në rajon duke bashkëpunuar në fusha me interes të përbashkët për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Kështu, UMSH është anëtar i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS. Si anëtar i këtyre rrjeteve, UMSH është në marrëdhënie dhe bashkëpunim të vazhdueshëm në formë projektesh të përbashkëta dhe shkëmbimi akademik me universitetet anëtare të këtij rrjeti. UMSH ndjek një politikë nxitëse për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar duke mundur dhe financuar pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme akademike brenda dhe jashtë vendit ku kanë marrë pjesë disa anëtarë të personelit të tij akademik.

